

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



CITATE TË ÇMUARA

Nga Imam Sejid Ali Khamenei

Tiranë, 2025

Titulli: Citate të çmuara nga Imam Sejid Ali Khamenei

I përzgjedhi dhe i përktheu:
Haxhi Shejkh Vullnet Merja

Redaktoi: Prof. Dr. Hajri Shehu

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie Feza

Kopertina: Sabrie Feza

Botues: Shoqata "Flladi
Tiranë, 2025

بسم الله الرحمن الرحيم

Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

Një prej dijetarëve të mëdhenj të kësaj kohe, i cili këshillon vazhdimisht këto ditë, është Lideri Suprem i Republikës Islamike të Iranit, Ajatullahu i madh, imam Sejid Ali Khamenei (*Allahu ia shtoftë jetën!*). Ai është i dashur brenda dhe jashtë Iranit dhe ka ndjekës të shumtë anembanë botës.

Në këtë libërth kemi përzgjedhur dhe kemi përkthyer këshilla të ndryshme, fetare, morale, sociale dhe politike të imam Sejid Ali Khamenit.

E lusim Allahun që besimtarët myslimanë shqiptarë, në veçanti dhe shqiptarët në përgjithësi, kudo që janë, të përfitojnë nga këto këshilla të mbushura me dije e udhëzim.

Haxhi Shejkh Vullnet Merja

CITATE TË ÇMUARA NGA IMAM SEJID ALI KHAMENEI

Imam Sejid Ali Khamenei ka thënë:

❖ Nuk ka dritë, përveç Allahut të Plotfuqishëm, sepse gjithçka është errësirë. Hyni në detin e mëshirës së Allahut, në detin e profecisë, në detin e Kur'anit të Shenjtë dhe zhytuni në thellësitë e tij!

❖ O myslimanë të botës dhe ju të shtypur që jeni nën pushtetin e shtypësve! Ngrihuni e bashkohuni dhe mbronit Islamin dhe pasuritë tuaja dhe mos kini frikë nga zhurma e mendjemëdhenjve arrogantë!

❖ Vëllezërit e mi! Nëse dëshironi të arrini dinjitetin e kësaj bote e të Botës Tjetër, qëndroni të fortë dhe të palëkundur përballë të huajve! Jini të mëshirshëm, të dhembshëm dhe miq me njëri-tjetrin!

❖ Edukojeni dhe disiplinojeni veten tuaj, sepse kjo botë është e vdekshme dhe ne të gjithë do ta lëmë atë - unë dhe më pas, ju! Le të kryejmë detyrën tonë, sepse Zoti Fuqiplotë nuk e ngarkon njeriun përtej mundësive të tij!

❖ Ruajini kufijtë e Islamit dhe mos i shpërdoroni liritë, sepse liria është e kufizuar me kufijtë e Islamit!

❖ Jini të mëshirshëm me gratë tuaja! Jini prindër me fëmijët tuaj, në kuptimin e vërtetë të fjalës! Komunikoni me fëmijët tuaj dhe trajtojini ata si miq e si prindër!

❖ Ymeti islam dhe shoqëria islame nuk duhet në asnjë moment të neglizhojnë ngjarjen e Ashurasë, sepse ajo është mësim dhe emblema udhëzimi. Është më se e vërtetë që Islami vazhdon të jetë i gjallë për shkak të Ashurasë dhe të Huseinit, birit të Aliut (*Paqja qoftë mbi të dy!*).

❖ Huseini i biri i Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk shkoi në Qerbela me qëllim lufte, sepse ai që shkon në fushën e betejës, duhet të ketë ushtarë. Imam Huseini i biri i Aliut mori me vete familjen e tij- gra e fëmijë. Kjo do të thotë se në atë vend do të ndodhë një ngjarje, e cila do të lëkundë

emocionet e njerëzimit gjatë historisë dhe të qartësohet madhështia e revolucionit që bëri Imam Huseini.

❖ Imam Huseini e dinte se armiqtë e tij ishin të neveritshëm dhe idiotë. Ai kishte mendimin se ata që erdhën për ta luftuar, nuk ishin tjetër, veçse një grup prej më të poshtërve dhe të neveritshmëve në Kufe. Dhe erdhën me shpresën për të marrë një dhuratë të vogël dhe të neveritshme. Kjo i shtyu ata drejt kësaj rruge dhe për të kryer atë krim kaq të madh. Ai e dinte se çfarë do të ndodhte me gratë dhe fëmijët e tij. Imam Huseini nuk ishte i pavetëdijshëm për asnjërën prej këtyre, por ai nuk ishte i gatshëm të dorëzohej dhe të hiqte dorë nga vendimi i tij; përkundrazi, ai kërkonte të vazhdonte rrugën, çka tregon rëndësinë e kësaj rruge dhe madhësinë e kësaj vepre.

❖ Njerëz të çdo ngjyre, race dhe sekti po bashkohen shumë shpejt në tubimet e muajit Muharrem. Shmangini fjalimet dhe debatet që e mbyllin këtë derë. Qerbelaja nuk është shkollë sektarizmi, por është shkollë e njerëzimit.

❖ Të dashurit e mi! Njeriu më i lartë është ai që ecën në Rrugën e Allahut dhe e kënaq Allahun. Është ai që nuk është rob i epsheve të veta. Ky është njeriu i sigurt dhe i

devotshëm. Njeriu materialist, që bie rob i epshit, inatit dhe i tekave, është i neveritshëm, sado i madh të jetë në dukje dhe sado pozitiv të lartë të ketë.

❖ Ne kemi titullin më të lartë të dashurisë. Është dashuria për Profetin Muhamed dhe dashuria për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi ta!*). Kulmi i kësaj dashurie shkon te Qerbelaja e te Ashuraja si dhe te ruajtja e kujtimeve të çmuara të sakrificave të njerëzve të Allahut në atë ditë. Ato sakrifica ruajnë historinë dhe kulturën e shiizmit. Në hadithe, thuhet se dashuria për Profetin dhe Ehli Bejtin është kusht themelor që myslimani ta plotësojë besimin e tij.

❖ Pritja e ardhjes së imam Mehdiut është një nga momentet më të bekuara të njeriut. Pritja e Mehdiut është një thesar i çmuar e popujt dhe kombet mund të përfitojnë shumë prej tij. Pritja e imam Mehdiut jep shpresë dhe rrit forcën. Fryma e kësaj pritjeje konsiderohet si një nga dritaret më të mëdha të lehtësimit për Bashkësinë Islame. Pritja e vërtetë është ajo që mbush botën me drejtësi dhe përhap drejtësinë në të gjitha fushat. Pritje do të thotë që ekzistenca e padrejtësisë dhe e shtypjes në botë është e paaftë për të shuar flakën e ndezur të shpresës në zemrat e atyre që presin.

❖ Shumë janë që mëtojnë (pretendojnë) se besojnë, por besimtarët janë të paktë. Nuk ka problem te numri i vogël, nëse ka besim të fortë.

❖ Dijeni se nëse një ditë heqim dorë nga mbështetja jonë tek Allahu dhe mbështetemi te nafta ose te armët, ajo është dita, kur ne shkojmë drejt humbjes dhe mposhtjes.

❖ Duhet t'i bindim vetët tona se edhe ne jemi njerëz, se ekzistojmë në këtë botë dhe se Lindja është një vend dhe se Perëndimi nuk është e gjithë Toka.

❖ Të gjitha fatkeqësitë, që na kanë ndodhur gjatë historisë, kanë ardhur nga padituria e njerëzve. Një popull që nuk ka udhërrëfyes, nuk mund të bëjë asgjë.

❖ Një fije floku nga koka e një prej të varfërve në kasolle dhe të atyre që dhanë dëshmorë, është më e nderuar dhe më e mirë se të gjithë pallatet e botës.

❖ Ne duhet ta lexojmë Kur'anin Famëlartë, sepse do të ndiejmë ëmbëlsinë e tij e nuk do të ndahemi kurrë prej tij dhe nuk do ta braktisim kurrë atë.

❖ Zakonisht ne e hapim letrën dhe e lexojmë. Përse e lexojmë letrën? E lexojmë për të mësuar se çfarë përmban ajo. Kështu duhet ta lexojmë Kur'anin Fisnik. Sepse Kur'ani është Mesazhi që na ka ardhur nga Zoti i Plotfuqishëm përmes krijesës më madhështore për sinqeritet, besueshmëri dhe vërtetësi. Dhe ky është Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Duhet ta kuptojmë Kur'anin dhe të përfitojmë prej Kur'anit.

❖ Ndër shenjat e besimit janë largimi nga gjynahet, frika ndaj Allahut, sjellja e mirë me të tjerët, kundërshtimi i armiqve të Allahut e të qenët i ashpër me ata, shpërfillja e mosmarrëveshjeve të vogla me vëllezërit dhe kërkimi llogari armiqve për çdo gjë të madhe e të vogël.

❖ Besimtari duhet ta hapë Kur'anin Famëlartë çdo ditë me nderëllë, me praninë e zemrës dhe të lexojë aq sa të mundet prej tij - qoftë dhjetë ajete, njëzet, pesëdhjetë apo njëqind ajete, duke mos lënë pas dore përsiatjen, duke e kuptuar atë, përsiatur dhe zbatuar në jetën e tij.

❖ Nëse e prezantoni Islamin në formën e tij të vërtetë para botës dhe nëse e zbatoni atë ashtu siç është, atëherë sovraniteti dhe lartësimi do t'ju takojnë juve.

❖ Kultivoni në vetët tuaja dhe tek të tjerët filizat e shpresës për të ardhmen dhe shkuleni nga vetët tuaja dhe nga të tjerët dëshpërimin dhe pesizimin! Ky është xhihadi juaj më kryesor dhe më i rëndësishëm. Kini kujdes nga djalli lakmitari! Largohuni nga kafshata haram!

❖ Kur'ani është flamuri i lartë i Islamit. Myslimanët duhet të kapen fort pas këtij flamuri dhe të mos ndahen kurrë prej tij. Kur'ani duhet të shihet patjetër në veprat tona, në jetën tonë, në sjelljet tona, në moralin tonë dhe në rrugëtimin e përgjithshëm të Ymetit Islam.

❖ Ne do të jemi besnikë ndaj kujtimit të Ashurasë dhe të gjitha sakrificave të saj, vetëm e vetëm kur biografia e saj të jetë e pastër dhe e kthjellët nga çdo risi apo ekzagjerim. Ngjarja e Ashurasë nuk ka nevojë për shtesa për të ngjallur emocione për të, apo për ta lartësuar atë. Përkundrazi, ne e fyejmë kur e nxjerrim nga origjinaliteti dhe pastërtia e saj. Pra, të mos e shtrembërojmë imazhin e Ashurasë me shprehje që nuk kanë të bëjnë me të apo që e fyejnë shenjtërinë e saj.

❖ Jezidi sundimtar nuk ishte në marrëdhënie me njerëzit, nuk ishte nga njerëzit e ditur, nuk ishte i devotshëm, as i pastër, as i urtë. Ai nuk ka bërë xhihad në Rrugën e Zotit, nuk besonte aspak në moralin e Islamit, nuk sillej si besimtar dhe fjalët e tij nuk ishin si thëniet e mençura. Ai ishte krejt i zhveshur nga çdo ngjashmëri me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij*). Në rrethana të tilla, Imam Huseinit iu dha mundësia që të kryente revolucionin e tij. Huseini është imami që duhej të ishte zëvendësi i të Dërguarin të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij*) për të udhëhequr myslimanët.

❖ Islami nuk është ai që paraqitin disa rryma të njohura devijuese, sepse Islami bazohet në logjikë, besim dhe arsyeshmëri solide.

❖ Prej çështjeve, për të cilat duhet pasur kujdes, janë leximi i Kur'anit dhe përhapja e dijeve kur'anore. Konceptet kur'anore të përfshihen në sloganet huseinijane, sepse ato ndezin në shpirt fanarët e revolucionit huseinijan që u realizua për hir të Islamit dhe të rikthimit të tij në jetë.

❖ Transformim etiko-moral do të thotë që njeriu të braktisë dhe të shmangë çdo ves, të largohet nga të gjitha moralet e këqija e të qortueshme dhe nga çdo shpirtëligësi që ndikon në dëmtimin e të tjerëve, ose e bëjnë personin të

prapambetur. Njeriu duhet të vishet me virtyte dhe tipare të bukura morale.

❖ Besimtari dhe njeriu që punon për hir të Zotit duhet që të gjitha fushat e jetës së tij të jenë për Zotin dhe për askënd tjetër. Një nga këto fusha është marrëdhënia me familjen, veçanërisht me gruan dhe fëmijët. Ju duhet të jeni manifestimi i moralit. Një incident i vogël jashtë shtëpisë mund t'ju zemërojë, por brenda shtëpisë ai zemërim nuk duhet të shfaqet.

❖ Transformim moral do të thotë shoqëri ku nuk ka zili dhe urrejtje, ku nuk ka mendimtarë që i përdorin mendimet e tyre për të thurur komplete kundër të tjerëve, për falsifikime dhe për mashtrime, ku nuk ka intelektualë e dijetarë që i përdorin dijet e tyre për të dëmtuar njerëzit dhe për të ndihmuar armiqtë e njerëzve, ku të gjithë anëtarët e saj ia duan të mirën njëri-tjetrit dhe nuk kanë smirë dhe nuk kërkojnë të jetojnë në kurriz të të tjerëve dhe nuk synojnë ta monopolizojnë gjithçka. Ky është transformimi moral.

❖ Mënyra më e mirë për të rritur një fëmijë është prehëri i nënës së tij dhe dhembshuria e dashuria e saj. Gratë që i privojnë fëmijët e tyre nga kjo dhuratë e Allahut, bëjnë

gabim. Ky privim i dëmton fëmijët e tyre, i dëmton vetë gratë dhe e dëmton shoqërinë.

❖ E dashur rini! Ndërsa ecët me vendosmëri në marshimin e Arbainit, ju duhet të jeni të fortë dhe të vendosur në rrugën e sundimit të Allahut dhe të jetoni gjithmonë si Imam Huseini (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të ndiqni rrugën e tij. Nëse rezistoni, atëherë do të pushtoni majat.

❖ Nuk duhet të lejohet shkelja e shenjtërisë së bashkëshorteve të pastra të Profetit. Bashkëshortet e Profetit janë të respektuara. Ai që e fyen njërin prej tyre, ka fyer Profetin (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi atë dhe mbi familjen e tij!*). Dhe këtë e them prerazi.

❖ Ajo që unë mund t'ju rekomandoj të rinjve është:

Së pari: I riu duhet të ndihet përgjegjës dhe ta konsiderojë veten person të përgjegjshëm. Ai duhet ta çajë vetë rrugën e tij në jetë e jo të jetë si pupla në erërat e ngjarjeve.

E dyta: Të lëvizë në jetën e tij me udhëzimin e besimit, sepse besimi ka rol të madh në përparimin e tij në të gjitha fushat dhe në të gjitha pengesat që i dalin në rrugën e tij.

Së treti: Ai duhet të jetë i vetëdijshëm dhe i matur në punët e tij.

❖ Njeriu duhet t'i mendojë thellë veprimet dhe thëniet e personaliteteve të mëdha si profetët dhe shenjtoret dhe të thellohet në aspektet e jetës së tyre, veçanërisht, në aspektet e përditshme, që kanë lidhje me familjet, bashkëpuntorët dhe nxënësit e tyre. Ato personalitete të larta janë fanar udhëzimi në jetë.

❖ Mësuesi jep dijen, mëson moralin dhe sjelljen. Të mësuarit e moralit dhe të sjelljes nuk është e njëjtë me mësimin e dijes, ku njeriu lexon dhe studion vetëm nga librat. Mësimi i moralit nuk mund të përcillet përmes librave. Sjellja është më ndikuese se librat dhe fjalët. Sjellja e njeriut tregon vërtetësinë e fjalëve.

❖ Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është galaktika më e ndritshme në univers. Ai ka mijëra sisteme dhe diej të ndritshëm të virtytit dhe të fisnikërisë. Ai ka diturinë, shoqëruar me moralin; qeverisjen, shoqëruar me urtësinë; adhurimin, shoqëruar me shërbimin ndaj njerëzve; xhihadin, shoqëruar me mëshirën; dashurinë për Allahun, shoqëruar me dashurinë për krijesat e Zotit; krenarinë, shoqëruar me përvulësinë;

modernitetin, shoqëruar me largpamësinë dhe me singëritetin me njerëzit.

❖ Çfarë mund të themi për Profetin më të madh, Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), përveç se: I Dërguari më i madh i Islamit është një tubim i plotë i virtyeteve të të gjithë profetëve dhe shenjtorëve gjatë historisë. Kur përmendim emrin e Profetit Muhamed, kristalizohet dhe mishërohet personaliteti i Ibrahimit, Nuhut, Musait, Isait, Lukmanit dhe të gjithë robve të drejtë të Zotit, si dhe personaliteti i Prijësit të besimtarëve dhe i imamëve të Udhëzimit (*Paqja qoftë mbi të gjithë ata*).

❖ Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që njeri i ndershëm, i sinqertë, i durueshëm dhe i vetëpërmbajtur. Ai që fisnik dhe mbrojtës i të shtypurve në çdo kohë. Ai që trim dhe nuk u përkul kurrë nga numri i madh i armiqve. Ai që i dhembshur, durimtar dhe bujar. Ai nuk që hakmarrës. Ai që jashtëzakonisht i sjellshëm. Ai kurrë nuk i zgjasti këmbët kur ishte ulur me të tjerët dhe kurrë nuk u tall me ta.

❖ Prej moraleve të Profetit ishte ndjenja e turpfit. Atij i vinte turp kur bënin faj të tjerët. Ai ecte me kokën ulur prej

modestisë. Qëndrimet e tij shkëlqejnë në faqet e historisë. Ai qe i mëshirshëm dhe jashtëzakonisht durimtar dhe adhures. Të gjitha këto cilësi qenë mishëruar në personalitetin e të Dërguarit fisnik në të gjitha etapat e jetës së tij, që nga rinia e tij deri në vdekjen e tij në moshën gjashtëdhjetë e tre vjeç.

❖ Prania e Profetit të madh të Islamit në nivel ndërkombëtar përbën një pikë lidhjeje midis të gjithë popujve muslimanë dhe mbarë ymetit Islam. Sot muslimanwt kanë shumë nevojë për Profetin e tyre më fisnik. Ata kanë nevojë për udhëzimin e tij, fjalën e tij, paralajmërimin e tij, mesazhin e tij, moralin e tij dhe mëshirën e tij, që ai ia mësoi njerëzimit. Mësimi i më të nderuarit Profet, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për ymetin e tij dhe për mbarë njerëzimin në kohën tonë është interesimi pwr diturinë, moralin, dinjitetin, mëshirën, krenarinë, xhihadin dhe rezistencën.

❖ Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sillej mirë me njerëzit. Ai i takonte njerëzit gjithmonë fytyrëqeshur dhe nuk ua tregonte atyre shqetesimet dhe problemet që i rëndonin në kraharor. Ai i përshëndeste të gjithë. Kur dikush e lëndonte, nuk ankohej

e as nuk e shfaqte lëndimin. Ai nuk lejonte askënd që në tubimin e tij të fyheshin të tjerët.

❖ Pjesa më e madhe e ushqimit të Profetit ka qenë bukë elbi ose hurma. Kanë shkruar historianët se kurrë nuk e ngopte barkun me bukë gruri. Profeti (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) hipte mbi deve pa samar. Në kohën kur njerëzit krenoheshin me kuajt e tyre të shtrenjtë e të shaluar, ai ngiste një kalë të zakonshëm. Profeti ishte i thjeshtë, i riparonte sandalet (shapkat) me duart e veta dhe i arnonte vetë rrobat. Kështu bënte edhe nxënësi i tij i shquar, Prijësi i besimtarëve, imam Aliu, siç thuhet në hadithe.

❖ Profeti (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qe shembull në adhurime. Ai falej e falej derisa i fryheshin këmbët nga qëndrimi i gjatë në namaz. Ai e kalonte pjesën më të madhe të natës në adhurim, lutje, duke qarë, duke kërkuar falje, duke u lutur dhe duke biseduar me Zotin e Madhëruar. Ai agjëronte muajt rexheb dhe shaban, përveç muajit të Ramazanit e përveç shumë ditëve të tjera të vitit. Dhe, kur shokët e tij i thoshin, o i Dërguar i Zotit, përse gjithë kjo lutje, kërkim faljeje dhe adhurim, kur Zoti të ka falur mëkatet e tua të mëparshme dhe të ardhshme, ai përgjigjej: A nuk duhet të jem rob mirënjohës?

❖ Çelësi i të gjitha reformave dhe i lumturisë sot në botën materiale është që njerëzit të kthehen te vetvetja, të kujtojnë dhe të kërkojnë qëllimin e krijimit përtej dukurive materiale të jetës - përtej të ngrënit, gjumit, epsheve, pushtetit, dashurisë për para etj. Rrënjët e shkatërrimit janë mosthëllimi në thellësinë e vërtetë të botës. Kuptimi dhe thelbi i vërtetë i jetës është kthimi te Krijuesi, tek detyrimet e përgjegjësitë dhe dëgjimi i urdhrave të Krijuesit të Urtë e të Plotfuqishëm për të dukshmen dhe të padukshmen.

❖ Drita e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ndriçonte vetëm kur ai shkonte në xhami dhe kur u fliste njerëzve. Ajo ndriçonte edhe kur ai ishte ulur në shtëpinë e tij, kur ishte në heshtje, kur ecte apo kur ishte në fushën e betejës. Në të gjitha këto situata dhe kushte, prania e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndriçonte. Ai ishte dritë dhe ndriçonte në çdo kohë. Kjo ndodhte ngaqë lëvizjet e tij ishin të përsosura, ngaqë qetësia e tij, fjalët dhe veprimet e tij ishin të gjitha në shërbim të Zotit dhe për hir të Zotit.

❖ Bota islame duhet të mbështetë popullin palestinez. Palestina është bërë më e gjallë në vetëdijen dhe zemrat e myslimanëve se më parë.

❖ Vrasja e grave, burrave, fëmijëve dhe pleqve palestinezë, përdhosja e shenjtërisë së xhamisë “Al-Aksa”, shtypja dhe rrahja e besimtarëve myslimanë në xhami dhe inkurajimi i kolonëve sionistë për të sulmuar popullin e pambrojtur të Palestinës janë prej krimeve më të zakonshme dhe më të përditshme që kryen regjimi sionist. Në rrethana të tilla, përball këtyre krimeve, populli dinjitar e i lashtë i Palestinës nuk kishte rrugë tjetër përveç të fillonte një stuhi të madhe.

❖ Lëvizja që nisi në Palestinë do të përparojë dhe do të çojë në fitoren e plotë të palestinezëve. Ngjarjet që Palestina ka dëshmuar ditët e fundit, veçanërisht bombardimet e përsëritura dhe martirizimi i grave, fëmijëve dhe pleqve, lëndojnë zemrën e njeriut. Ndërkohë, një pjesë tjetër e këtyre ngjarjeve tregon fuqinë mahnitëse të Islamit në Palestinë.

❖ Sot, në rastin e Gazës, të gjithë ne kemi përgjegjësinë të reagojmë. Duhet të reagojmë. Mijëra njerëz janë të uritur, janë nën bombardime dhe po martirizohen. Një studiues ose një universitet duhet të përpiqet të njohë të vërtetën dhe t'i qëndrojë asaj. Të shikosh me indiferentizëm këtë çështjen e Gazës nuk është e lejueshme për dijetarët dhe shkencëtarët.

❖ Nëse këto krime vazhdojnë, myslimanët dhe forcat e rezistencës nuk do të durojnë dhe askush nuk do të jetë në gjendje t'i ndalojë ata.

❖ Fuqitë arrogante ndjekin forma politike dinake e mashtruese. Kjo është një praktikë e njohur historike. Ata nuk pengohen nga vlerat morale, as nga ndjenjat njerëzore, sepse janë distancuar në ambicien e tyre të paligjshme. Këtë e shohim edhe sot me qëndrimin e tyre ndaj masakrave barbare në Palestinë.

❖ Armiku barbar dhe gjakpirës nuk merr parasysh kurrfarë kufiri në vrasjen dhe masakrimin e fëmijëve, grave, burrave, pleqve e të rinjve. Popullata civile e Rripit të Gazës është e shtypur dhe viktimë me kuptimin e thellë dhe të vërtetë të fjalës.

❖ Populli i Gazës është, me të vërtetë i shtypur. Armiku i pamëshirshëm dhe gjakatar, regjimi terrorist uzurpues nuk njeh kufij për krimet. Vret mijëra njerëz të pafajshëm me bombardime.

❖ Regjimi i vrasës dhe pushtues izraelit po hakmerret duke vrarë civilë në Rripin e Gazës për goditjen e rëndë që e pësoi nga luftëtarët e rezistencës palestineze.

❖ Palestina është pjesë e ymetit Islam. Dhe pushtimi i Palestinës do të thotë pushtim i tokës islame. Krijimi i shtetit sionist u arrit nga arroganca globale kundër ymetit islam. Është detyrë e të gjithë myslimanëve që të kontribuojnë në këtë luftë dhe të ofrojnë mbështetje për atë pjesë të trupit islam që është në duart e armikut.

❖ Përpjekjet, shtypjet dhe krimet e sionistëve janë të kota dhe nuk do të çojnë askund. Në të ardhmen Palestina do t'u përkasë palestinezëve, jo regjimit sionist.

❖ Fuqitë hegjemoniste të botës po e shikojnë se si pasojë e goditjes së madhe dhe vendimtare të luftëtarëve të rezistencës palestineze, regjimi sionist është duke u shembur dhe shkatërruar. Prandaj pikërisht për këtë arsye ata po mundohen ta mbajnë në këmbë regjimin e plagosur dhe të gjunjëzuar sionist me udhëtimet e tyre duke shprehur solidaritet me të dhe duke i vënë në dispozicion të gjitha mjetet për kryerjen e krimeve, si bombat dhe armatimet e ndryshme.

❖ Fryma e besimit dhe motivi i xhihadit për hir të Zotit, kur u bashkuan me qëndresën e popullit palestinez, krijuan pengesën më të madhe për realizimin e planeve të arrogancës globale.

❖ U bëj thirrje vëllezërve palestinezë dhe motrave palestineze: Vazhdoni luftën tuaj, vazhdoni qëndrueshmërinë dhe rezistencën tuaj, sepse pavarësia dhe identiteti nuk do të arrihet, veçse me vendosmëri dhe rezistencë.

❖ Populli palestinez, me rezistencën, qëndrueshmërinë, trimërinë dhe palodhshmërinë e tij ka dëshmuar aftësinë e triumfit të gjatë kundër shpatës.

❖ Fuqia e arrogancës vjen nga bombat, presioni ushtarak, mizoria dhe krimi. Por fuqia e besimit me ndihmën e Zotit do t'i mposhtë të gjitha këto.

❖ Populli i Gazës, me qëndrimin e tij lëvizi ndërgjegjen njerëzore. Sot ju shihni se edhe në rrugët e Amerikës dhe të vendeve perëndimore, turma të mëdha po brohorasin kundër Izraelit dhe në shumë raste - kundër Amerikës.

❖ Populli palestinez u zgjua dhe triumfi do të jetë aleati i tyre.

❖ A është terrorist kushdo që mbron shtëpinë dhe vendin e tij?! A ishin terroristë francezët që luftuan gjermanët në Paris në Luftën e Dytë Botërore?! Si është e mundur që ata janë luftëtarë dhe një burim krenarie për Francën, ndërsa të rinjtë e Xhihazit dhe Hamasit qenkan terroristë?!

❖ Brezi i ri në Palestinë e zgjodhi rrugën me gjemba bazuar në bindje dhe në besim.

❖ Sionistët e konsiderojnë veten raca superiore dhe e shohin me përçmim pjesën tjetër të racës njerëzore; prandaj kanë masakruar mijëra fëmijë pa asnjë brejtje ndërgjegjeje.

❖ Veprimi kryesor është të ndërpriten rrugët dhe kanalet jetike të regjimit pushtues sionist dhe qeveritë e vendeve islame duhet ta pengojnë në mënyrë serioze arritjen e energjisë dhe të mallrave të ky regjim pushtues.

❖ Rrethanat aktuale të rajonit, më shumë se në të kaluarën kanë nevojë për forcimin e marrëdhënieve të vendeve të rajonit dhe të mos ndikohen nga politikat që vijnë nga faktorët e huaj.

❖ Bota e ardhshme është bota e Palestinës, jo e uzurpuesit sionist dhe e ardhmja u përket palestinezëve. Sa u përket përpjekjeve që bëjnë uzurpuesit duke bërë padrejtësi dhe duke kryer krime e mizori, të gjitha janë të kota dhe nuk do të arrijnë asnjë rezultat, inshaAllahu. Shpresojmë që Zoti i Plotfuqishëm të bëjë atë që është më e mira për botën islame, për ymmetin islam dhe t'i bëjë armiq të ymmetit islam të pikëlluar, të shtypur e të poshtëruar.

❖ Çështja e Palestinës, me ndihmën e Zotit, është duke lëvizur drejt zgjidhjes, që do të thotë drejt formimit të shtetit të Palestinës në të gjithë territorin e Palestinës. Pikëpamja e Republikës Islamike të Iranit nuk është "hedhja në det e askujt", por është kjo që duhet të formohet një shtet duke u bazuar në mendimin dhe votën e popullit palestinez.

❖ Sa i përket çështjes së Palestinës, nëse shtetet islame që nga dita e parë do të qëndronin dhe do të rezistonin fuqishëm dhe të palëkundur, me siguri që sot gjendja e

rajonit të Azisë Perëndimore, do të thotë, të rajonit tonë, do të ishte më ndryshe. Sot ne do të ishim më të fuqishëm, do të ishim më të unifikuar dhe nga aspekte të ndryshme, sot gjendja jonë do të ishte shumë më ndryshe.

❖ Ne themi që vota e njerëzve përcakton të ardhmen. Qeveria që do të formohet me votat e popullit palestinez do të vendosë nëse ata që kanë ardhur nga vende të tjera do të mbeten apo do të largohen.

❖ Arroganca globale përfshin të gjitha forcat sunduese në botë dhe të gjitha fytyrat e paturpshme që sundojnë popujt.

❖ Konfliktet që kanë ndodhur në botë në të kaluarën, që ndodhin në të tashmen, apo që do të ndodhin në të ardhmen, shkaktohen ngaqë fuqitë arrogante kërkojnë të përcaktojnë të ardhmen e popujve, ashtu siç dëshirojnë ato.

❖ Arroganca e djallwzuar është kujdesur ta përhapë frontin e saj në të gjitha vendet e botës. Ajo i ka ndërlikuar të gjitha çështjet e jetës njerëzore dhe i ka prekur të gjitha grupet njerëzore në shoqëri. Me frontin e shejtanit, kam parasysh materializmin perëndimor, që planifikojnë prijësit

e të keqes dhe të arrogancës, i cili bazohet në interesat e pronarëve të kompanive të mëdha, te kapitali i madh, te tirania e tyre dhe te pangopësia e tyre.

❖ Zonja Fatime Zahra (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), ky yll ndriçues në botën e ekzistencës, nuk është vetëm ajo që dëgjojmë me veshët tanë. Zonja Fatime Zahra, është shumë më e lartë se këto përshkrime. Ne shohim vetëm shkëlqimin e dritës, por ajo është shumë më e lartë se përshkrimi.

❖ O Zot, për hir të Muhamedit dhe të familjes së Muhamedit, mos na privo nga dashuria për Fatime Zahranë dhe nga vilajeti i saj në këtë botë dhe në Ahiret! Na udhëzo me dritën e Zahrasë së dëlirë! O Zot, shtoje dashurinë për të në zemrat tona ditë pas dite dhe bëje që Ymeti ynë ta dojë familjen e Pejgamberit (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)! Na tubo në Ditën e Gjykimit me dashurinë për familjen e Profetit!

❖ Çfarë përfitojmë unë dhe ju nga ky rrezatim dhe shkëlqim i Zonjës Fatime Zahrasë?

❖ Nëpërmjet këtij ylli të ndritshëm ne duhet të gjejmë rrugën drejt Zotit, e cila është Rruga e së Vërtetës. Fatime

Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*) e rrugwtoi Rrugën e sw Vwrtetws dhe arriti majat më të larta tw saj.

❖ Krimi i uzurpimit të Palestinës, paraqet një faqe të njollosur të historisë që do të mbyllet si faqet e tjera të ndotura, me lejen dhe ndihmën e Zotit të Madhëruar. Zoti i Madhëruar në ajetin 81 të sures “Isra” thotë: **“Pa dyshim, e pavërteta do të zhduket”**. Kurse në ajetin 105 të sures “Enbija”, Allahu Fuqiplotë thotë: **“Tokën e trashëgojnë robtë e Mi të drejtë.”**

❖ Nga këndvështrimi islam, çështja e Palestinës është një çështje themelore dhe një detyrë për të gjithë myslimanët. Të gjithë dijetarët e shkuar dhe të sotëm, shiitë dhe sunitë, janë shprehur se nëse armiqtë e Islamit pushtojnë një vend islam, është detyrë e të gjithë myslimanëve ta mbrojnë atë për të rifituar tokat e uzurpuara. Secili ka detyrën e tij në lidhje me çështjen palestineze, si të mundet. Së pari, e ka detyrë nga ana islame. Toka islame, e pushtuar nga armiqtë e Islamit duhet të rikthehet.

❖ Në mediat ndërkombëtare u bënë përpjekje për t'i portretizuar hebrenjtë, që pushtuan Palestinën, si njerëz që u qenkan dhunuar të drejtat e që qenkan përballur me

presione dhe sulme. Ndërsa arabët, që po përpiqeshin të rifitonin shtëpitë e tyre, paraqiteshin si njerëz mizorë, që flitkan me logjikën e forcës dhe nuk u përmbahen standardeve dhe rregulloreve. Përveç kësaj, elementët sionistë dhe amerikanë shfaqnin në mediat e tyre fotografi të disa grave dhe fëmijëve hebrenj të lodhur, në mënyrë që njerëzit në botë të thonë: Çudi e madhe! Përse arabët sillen në këtë mënyrë me këta njerëz të varfër e të shtypur?!

❖ Rilindja Islame, ose të themi, Zgjimi Islamik, u shfaq me forcë të plotë në rajon dhe në botën islame pas fitores së Revolucionit Islamik në Iran dhe lëvizjes së Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të*) gjatë dy dekadave të fundit. Boshti kryesor i kësaj Rilindjeje dhe i kryengritjeve është çështja palestineze. Kryengritja “Al Aksa” ishte një mundwsi qw të tërhiqte të gjithë popujt myslimanë dhe arabë në arenë, madje edhe jashtë kufijve gjeografikë të Palestinës dhe jashtë fushëveprimit të popullit palestinez.

❖ Nga pikëpamja humanitare, shtypja e familjeve palestineze imponon një detyrë mbi çdo njeri që t’i përkrahin të shtypurit. Sa padrejtësisht e trajtojnë popullin palestinez! Dhe ajo që është e habitshme është se organizatat e të drejtave të njeriut kanë vdekur.

❖ Njeriu në formën e tij më të lartë dhe në jetën më të plotë është ai që lëviz për hir të Zotit, është i kënaqur me Zotin dhe nuk është i pushtuar nga epshet e tij. Ai është njeriu i shëndetshëm dhe i përsosur. Ndërsa njeriu materialist është rob i epshit, i inatit, i tekave psikike dhe i ndjenjave të tij. Ai është njeri i neveritshëm, sado i madh të duket dhe sado pozitiv të lartë të ketë.

❖ Në një shoqëri, në të cilën sundon morali i mirë, si falja, vëllazëria, dashamirësia, drejtësia, dituria, përpjekja për të vërtetën dhe drejtësinë dhe nuk ka cilësi të këqija në mesin e anëtarëve të saj, njerëzit do të jetojnë si në parajsë.

❖ Identiteti i vërtetë i shoqërisë është morali. Shtylla kryesore e shoqërisë është modeli i saj moral sepse mbi bazën e tij formohet gjithçka. Nëse një popull a një vend zbrazet nga parimet morale dhe etike, ai ka humbur identitetin e tij të vërtetë.

❖ Etika dhe virtytet morale janë sqaruar dhe detajuar në ligjin e shenjtë islam. Ato kanë të bëjnë me vetë qenien njerëzore, si: durimi, mirënjohja, sinqeriteti, kënaqësia, etj. Po ashtu, janë sqaruar çështjet që lidhen me marrëdhëniet e njerëzve ndërmjet tyre, siç janë: falja e tjetrit, modestia,

altruizmi, nderimi i njeriut, etj., si dhe çështjet që lidhen me të gjithë shoqërinë islame janë në ligjin islam.

❖ Etika dhe morali islam ka shtrirje shumë të gjerë. Në çështjet e moralit janë përqendruar shumica e përpjekjeve të të gjithë profetëve dhe feve kryesore, si dhe përpjekjet e Profetit më të nderuar të Islamit, imamëve dhe figurave kryesore në Islam. E vërteta është se një nga kufijtë mes Islamit dhe kohës paraislame është çështja e moralit.

❖ Mesihu, biri i Merjemes, mbajti mbi supet e tij flamurin e udhëzimit të njerëzve dhe shpëtimin e tyre në kohën e humbjes, të injorancës, nënçmimit të vlerave njerëzore. Ai luftoi tiraninë, arrogancën, paragjykimet dhe padrejtësinë. Dhe i palëkundur në rrugën e përhapjes së drejtësisë, mëshirës dhe monoteizmit. Besimtarët - myslimanë dhe të krishterë duhet të kthehen te mësimet e profetëve, për të pasur një sistem të përshtatshëm mbarëbotëror. Ata duhet të përhapin virtytet njerëzore, bazuar në mësimet e profetëve, që janë mësuesit më të mëdhenj të humanizmit dhe të vlerave të larta njerëzore.

❖ Rëndësia e Mesihut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) në Islam nuk është më e paktë se sa rëndësia dhe vlera e tij në sytë e besimtarëve të krishterë. Gjithë jetën e tij, ky Profet i

madh qëndroi në mesin e njerëzve dhe përballë padrejtësisë dhe të padrejtëve, përballë agresivitetit dhe shkatërrimit, agresorëve dhe shkatërrimtarëve, të cilët shfrytëzonin pasurinë dhe fuqinë për të skllavëruar popujt. Ai, qëkur lindi, për hir të Allahut, përballoi të gjitha hidhësitë.

❖ Myslimanët thonë se Merjemja simbolizon pastërtinë dhe ndershmërinë, pra, ajo është plotësisht femër e pastër. Ka disa ajete në Kur'an, që flasin për Merjemen (Marinë), si për shembull: **“Merjemja, bija e Imranit, që e ruajti nderin e saj dhe në të i frymë nga Shpirti Ynë”**. (Sure “Tahrim”, ajeti 12). Ajo ishte në gradën e pagabueshmërisë. Si arriti ajo në këtë shkallë? Për mendimin tim, kjo është shumë e rëndësishme. Cilët ishin faktorët që një vajzë e vogël të hynte në tempull dhe të qëndronte aty deri në moshën e rinisë dhe t’u rezistonte pëshpëritjeve? Nëse ajo fuqi nuk do të ishte mbi fuqinë njerëzore, Kur’ani nuk do të thoshte: **“e ruajti nderin dhe pastërtinë e saj”**. Kjo është shumë e rëndësishme dhe është një mësim për të gjithë ne.

❖ Shpresa jonë është që të gjithë ithtarët e Mesihut dhe të gjithë ata që besojnë Mesihun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pozitën e tij të lartë, të ndjekin shembullin e tij dhe të veprojnë sipas urdhërimeve dhe mësimeve të tij.

❖ Udhëzimi i Isait, (*Paqja qoftë mbi të ta!*), është adhurimi i Allahut dhe nxitja për t'u përballur me faraonët dhe tiranët.

❖ Ata që zhurmojnë me ndjekjen e këtij të dërguari të nderuar të Allahut (Isai) janë ulur sot në kolltukun e faraonëve dhe të tiranëve, të cilët i luftoi Isai, biri i Merjemes (*Paqja qoftë mbi ta!*).

❖ Sot, pushtuesit izraelitë, Amerika dhe Britania janë në të njëjtën faqe në sytë e botës. Përdorimi i vetos nga Uashingtoni në rezolutën e Këshillit të Sigurimit në lidhje me armëpushimin në Gaza e ka hequr maskën nga fytyra e rreme e qyterërimit perëndimor.

❖ Të gjitha devijimet që ndodhin në shoqëri i kanë rrënjët dhe origjinën e tyre në moralin tonë. Veçoritë dhe karakteristikat morale të njerëzve janë ato që japin formë dhe drejtojnë veprimet e tyre. Nëse shohim shtrembërime të sjelljes në një shoqëri apo në nivel global, duhet t'i kërkojmë rrënjët e kësaj në moralin e keq e të qortueshëm.

❖ Ne vërejmë në nivel botëror se shumica e tragjedive që u ndodhin njerëzve janë si rezultat i moralit të keq dhe i

degradimit në moralin e disa individëve. Natyrisht, nuk harrojmë arsyet politike dhe ekonomike.

❖ Nëse kërkojmë dhe hulumtojmë rrënjët e të gjitha çështjeve negative dhe shkatërruese, do të gjejmë se është morali i keq. Problemet e njerëzimit sot vijnë nga tirania politike në botë. Dhe tirania është për shkak të moralit. Problemet e njerëzve në përgjithësi shpesh ndodhin për shkak të paditurisë së tyre.

❖ Vërtet, çdo gjë që mund të themi për të nderuarën Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*) është shumë pak. Ne nuk dimë atë që duhet të themi dhe atë që duhet të meditojmë për lulen Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse dimensionet ekzistenciale të kësaj hyrie njerëzore, shpirti i sinqertë, janë të gjera, të pafundme dhe të pakonceptueshme. Nga përshkrimi i saj, njeriu hutohet. Allahu i Madhëruar ia largoi fëlliqësinë dhe e pastroi atë plotësisht.

❖ Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka pasur një pamje, të cilën që nuk e lavdëronin vetëm i ati, të afërmit, bijtë e saj dhe rrethi i ngushtë i saj. Atë e lavdëronin edhe ata që nuk kishin lidhje të forta me të. Shikojini librat që janë shkruar për Fatime Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*) apo rreth

mënyrës së sjelljes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me këtë krijesë.

Hadithet pwr Fatimenw janë transmetuar jo vetëm nga bashkëshortet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), por edhe nga të tjerë. Po përmendim transmetimin e njohur nga Aishja: “Nuk kam parë njeri më të ngjashëm me të Dërguarin e Allahut në heshtje, në argumentim, në qetësi dhe në të folur se sa Fatimja. Kur ajo hynte tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ai ngrihej në këmbë dhe shkonte drejt saj me dashuri.”

Në disa transmetime të tjera, të transmetuara, gjithashtu, nga Aishja, vjen kështu hadithi: “Ai e puthte atë dhe e ulte në vendin ku ishte ulur vetë.” Kjo është e dëshmuar në biografinë e saj. Prandaj, njeriu i logjikshëm, të cilit Zoti i Madhëruar i ka dhënë sytë të shohë, duhet të përfitojë nga jeta e këtij ylli.

❖ Nuk ka dyshim se ylli i Krijuesit, krijesës Zehra, nuk është ajo që ne e shikojmë apo e imagjinojmë; ajo është shumë më madhështore se kaq. Ne shikojmë nurin e personalitetit të Zahrasë, por edhe ky është shumë më madhështorë se sa kaq. Atëherë, çfarë përfitojmë ne prej saj? Lexoni këtu, në njërën nga transmetimet e përmendura: “Me të vërtetë, ajo u paraqitet banorëve të qiellit, pasi ne nuk

jemi asgjë para këtij nuri (drite). Melekët më të afërt tek Allahu i Madhëruar, në qiellin më të lartë, u verbohen sytë nga nuri i Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Prandaj, edhe ne duhet të udhëzohemi me të, drejt Allahut dhe rrugës së adhurimit. Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) e zgjodhi këtë rrugë dhe u bë Zahraja dhe ju e shihni se si Allahu i Madhëruar e ka krijuar atë me një formë superiore, sepse Ai e dinte se ajo do të dilte me kokën lart nga provimi në botën lëndore. Në zjaretin e Fatimesë lexojmë: "Allahu të provoi ty që para se të krijonte dhe të pa durimtare, kur të provoi." Krijuesi i gjithësisë, i Madhërishmi, e përsosi atë baltë dhe e bëri superiore. Ky është njëri nga aspektet e jetës së Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilën ne kemi nevojë për të pastruar shpirtrat tanë.

O Allah, mos na largo nga dashuria për Zahranë në dynja dhe në Ahiret, për hir të Muhamedit dhe familjes së tij! Na udhëzo ne me dritën e saj të pastër!

O Allah, shtoje ditë pas dite dashurinë për të në zemrat tona dhe na bëj që të vdesim me dashurinë për familjarët e Profetit Muhamed! Në Ditën e Gjykimit na tubo rreth dashurisë së familjes së Profetit Muhamed!

❖ Nëse sot në botë ka padrejtësi dhe dominim dhe qytetërimi i dhunshëm perëndimor e mbush botën me atmosferë dhune, padrejtësie, arbitrariteti, gënjeshtre, nëse sot ka dominim të Fuqive të Mëdha mbi popujt dhe plaçkitje të pasurive të tyre nga çdo anë e globit, kjo është vetëm për shkak të shkatërrimit të moralit dhe të etikës njerëzore.

❖ Qëndrimi pranë rezistencës palestineze është detyrë, kurse qëndrimi pranë sionistëve është krim dhe tradhti.

❖ Fitorja e madhe e arritur nga populli palestinez është se ata kanë hedhur përdhe dinjitetin e Perëndimit dhe të Amerikës dhe demaskuan ata që zhurmojnë për të drejtat e njeriut. Pa dyshim, fitorja do t'i shkojë Frontit të së Vërtetës dhe entiteti sionist uzurpues do të shkulet nga toka.

❖ Lutjet, veçanërisht ato në muajt e bekuar të rexhebit dhe të shabanit janë prelude. Ato e zbukurojnë dhe e veshin zemrën për të marrë pjesë në pritjen e Zotit (Muaji i Ramazanit).

❖ Kur morali, etika dhe virtyti izoloohen, mbizotërojnë e keqja dhe korrupsioni, vlera e parasë dhe forcës

maksimizohet dhe ata që kanë fuqi dhe pasuri nuk do të vërejnë asnjë pengesë për arritjen e qëllimeve të tyre dhe bota do të bëhet, siç e shihni atë sot.

❖ Në demokracitë perëndimore ka forca të caktuara që shpesh marrin parasysh përkatësitë partiake. Në sistemin e Republikës Islamike, përveç dijes dhe kompetencës politike, nevojitet edhe kompetencë morale dhe ideologjike.

❖ Nëse një produkt kulturor i gabuar përhapet në një vend, duhet ta konsiderojmë armiqësor ndaj njerëzimit dhe duhet të përballlet me qëllimin e mbrojtjes së njerëzimit.

❖ Muaji rexheb është muaji i pastrimit të zemrave dhe të shpirtit, muaji i lutjes, i përuljes, i përkujtimit, i pendimit, i pastrimit nga gjynahet dhe veprat e këqija. Lutjet, itikafi dhe namazi në muajin rexheb, na ndihmojnë të pastrojmë zemrat dhe shpirtrat tanë, të largohemi nga gjynahet dhe të punojmë më tej për të pastruar shpirtrat tanë.

❖ Muaji rexheb është muaji i lutjeve dhe i përkujtimeve. Nëse bëjmë një veprim të dëshirueshëm, atëherë duhet ta dyfishojmë në këtë muaj. Nëse nuk e kemi bërë më parë atë veprim të dëshirueshëm, duhet ta fillojmë tani. E kam

përmendur më parë se ju jeni ende të rinj dhe puna juaj duhet të jetë e shoqëruar me besimin në Zot. Prandaj duhet ta shfrytëzoni këtë energji dhe të ndërtoni personalitetin tuaj në përmasat morale dhe materiale.

❖ Është e rëndësishme të dimë se çfarë ndikimi ka kultura në të ardhmen e vendit dhe se si vëmendja ndaj çështjes kulturore dhe ndjeshmëria ndaj saj mund të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin e së ardhmes që dëshirojmë dhe punojmë për të.

❖ Baza dhe origjina e kulturës është besimi dhe përshtypja e çdo njeriu për realitetet dhe të vërtetat e botës dhe të ekzistencës. Po ashtu, baza e kulturës është morali individual dhe morali shoqëror.

❖ Është detyra jonë zgjerimi i kulturës së popullit.

❖ Revolucioni Islamik mori në dorë një vend që i ishte nënshtruar një transformimi kulturor gjithëpërfshirës ose një sulmi të ri kulturor përballë së kaluarës.

❖ Fatkeqësisht, lëvizja kulturore e Evropës u shoqërua me atë që quhet hipnozë intelektuale, pasi praktikisht çoi në heqjen e fesë nga jeta e njerëzve dhe i dha vlerë më të madhe idesë së origjinalitetit njerëzor në filozofi dhe në sjellje.

❖ Kultura, në kuptimin e saj të vërtetë nuk nënkupton ndonjë armiqësi ndaj fesë ose adhurimit.

❖ Drejtësia sociale është një nga frytet dhe rezultatet e një kulture të shëndoshë në mendjen e çdo anëtari të shoqërisë dhe është diçka që nuk mund t'u imponohet njerëzve.

❖ Sulm kulturor është kur një forcë politike ose ekonomike lufton parimet kulturore të një populli për të arritur qëllimet e veta dhe për të kontrolluar të ardhmen e atij populli.

❖ Shkëmbimi kulturor arrihet kur kombi ka fuqi dhe vetëdije të plotë. Sa i përket sulmit kulturor, ai ndodh kur kombi dobësohet.

❖ Është detyrë të mbrohet kultura e Ymetit, Kur'ani i tij, xhihadi i tij, besimi i tij, përmes martirizimit dhe xhihadit.

❖ Kur'ani është shërim për dhembjet dhe vuajtjet, morale, shpirtërore të njerëzimit. Wshtw shwrim pwr vuajtjet e shoqërive njerëzore qw u sjellin luftërat, padrejtësitë dhe mungesa e drejtësisë.

❖ Kur'ani është paralajmërues dhe ne kemi nevojë për paralajmërim sepse na bën të vetëdijshëm për rreziqet që kërcënojnë njerëzit në këtë botë dhe në Botën Tjetër, e cila përfaqëson jetën reale.

❖ Sa më i vështirë të jetë shërbimi ndaj njerëzve, aq më shumë shtohet qetësia shpirtërore e një personi pas përfundimit të këtij shërbimi. Çdo punë që u shërben të dobëtëve, ka vlerë të madhe, InshaAllahu!

❖ Sikur t'i ishte dhënë mundësia Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ai do të kishte ndërtuar një botë të begatë, materialisht dhe moralisht, të drejtë, të

qëndrueshme, të paqtë. Këtë botë njerëzimi nuk e ka parë kurrë.

❖ Duhet të prodhohen filma për të reformuar kulturën e përgjithshme islame. Radioja dhe televizioni duhet të punojnë gjithmonë për kulturën e përgjithshme.

❖ Fatkeqësisht, ka pasur dhe ka njerëz në botën islame që imagjinojnë dhe besojnë se Kur'ani është vetëm për zemrat dhe për qoshet e faltoreve. Ata thonë se njerëzve u duhet Kur'ani për nevojat e tyre dhe marrëdhëniet personale me Allahun. Ata nuk e pranojnë Islamin që plotëson nevojat e shoqërive, as Islamin politik, as Islamin që ndërton një sistem shoqëror.

❖ Bota islame sot mban zi për Gazën. Ata që nuk e nuhatin aromën e njerëzishmërisë, e persekutuan popullin e Gazës. Është e sigurt se përgjegjësia më e madhe është të mbështesim atë popull të shtypur, rezistencën e guximshme dhe sakrifikuese, forcat e rezistencës në Gaza, Palestinën dhe të gjithë ata që i ndihmojnë nga cepat e botës islame. Po, populli i Palestinës është i shtypur. Jo vetëm bota islame, por edhe jomyslimanët e lirë, sot vajtojnë popullin e shtypur të Gazës dhe lavdërojnë e luten për rezistencën palestineze.

❖ Leximi i Kur'anit - kjo vepër e njohur në vendet islame, është bërë e njohur edhe në vendin tonë, falë Zotit. Leximi i Kur'anit një nga hapat më të efektshëm drejt njohjes me Kur'anin dhe me njohuritw e tij. Vlera sublime e leximit të Kur'anit qëndron në faktin se ai na inkurajon të reflektojmë për ajetet dhe konceptet e Kur'anit dhe na qartëson dijet e tij.

❖ Ju uroj nga zemra ardhjen e muajit të bekuar të Ramazanit. Lus Zotin që t'ju japë suksese në adhurime në këtë muaj të shenjtë. Muaji i Ramazanit është muaji i adhurimit, i lutjes, i leximit të Kur'anit, i shkollës së durimit dhe i kontrollimit të dëshirave. Është muaji i formimit të karakterit dhe i vetedukimit në të gjitha fushat.

❖ Në këtë muaj, myslimanët duhet të përfitojnë nga atmosfera e agjërimit, e Kur'anit dhe e adhurimit, për të pastruar shpirtrat e tyre, për të ngritur moralin e tyre dhe për të pastruar shoqëritë e tyre nga shkujdesja, vetëkënaqësia, dekadencia dhe shfaqjet e tjera negative që vijnë nga zhytja e gjatë në kënetat e kulturës koloniale.

❖ Vëmendja ndaj adhurimit në këtë muaj nuk kufizohet vetëm në vëmendjen ndaj namazit dhe lutjes, por përfshin edhe adhurimet në përgjithësi. I Dërguari i Allahut

(Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i ka mobilizur myslimanët në këtë muaj për dy beteja. E para përfundoi me fitoren e Bedrit dhe e dyta me çlirimin e Mekës.

❖ Agjërimi është shkallë për të arritur tek devotshmëria. Zoti i Urtë thotë në Kur'an: **“O ju që besuat, agjërimi u është bërë detyrim sikurse ishte detyrim edhe i atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.”** Pra, agjërimi të çon në devotshmëri dhe mjetet për ta siguruar këtë janë zemrat tuaja. Devotshmëri do të thotë që njeriu të jetë në gjendje monitorimi në të gjitha veprimet dhe veprat e tij, për të parë nëse ato janë në përputhje me kënaqësinë e Zotit dhe me urdhrat e Tij, apo jo. Kjo gjendje e monitorimit dhe e kujdesit të vazhdueshëm quhet devotshmëri.

❖ Devotshmëri do të thotë që njeriu të jetë në gjendje monitorimi në të gjitha veprimet dhe veprat e tij, për të parë nëse ato janë në përputhje me kënaqësinë e Zotit dhe me urdhrat e Tij, apo jo. Kjo gjendje monitorimi e kujdesi të vazhdueshëm quhet devotshmëri. E kundërta e kësaj gjendjeje është gafleti, mungesa e vigjilencës dhe e veprimit pa mprehtësi.

❖ Allahu i Plotfuqishëm nuk e do shkujdesjen dhe humbjen e mprehtësisë së besimtarit në punët e jetës. Besimtari duhet të ketë sy të mprehtë dhe zemër vigjilente në të gjitha çështjet e jetës. Kjo mprehtësi dhe kjo zemër e vëmendshme dhe e vetëdijshme i parathënë besimtarit se veprimet që ai ndërmerr, nuk janë në kundërshtim me vullnetin e Zotit, as me rrugën e fesë dhe as me rregullat dhe dispozitat e saj.

❖ Një popull ose një individ që ka aftësinë për të qenë i devotshm do t'i gëzojë të gjitha të mirat. Devotshmëri do të thotë që njeriu të jetë në gjendje mbikqyrjeje në të gjitha veprimet dhe veprat e tij, për të parë nëse ato janë në përputhje me kënaqësinë e Zotit dhe urdhrat e Tij, apo jo.

❖ Devotshmëria nuk është vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të hyrë në Xhenet në Ditën e Kiametit. I devotshmi e sheh dobinë e devotshmërisë edhe në këtë botë. Shoqëria e devotshme, shoqëria që zgjedh Rrugën e Zotit dhe e ndjek me kujdes, i gëzon mirësitë e Allahut edhe në këtë botë. Allahu i Madhëruar i dhuron asaj shoqërie dituri për punët dhe çështjet e saj.

❖ Devotshmëria është porosia e parë dhe e fundit e profetëve. Ne në një sure të Kur'anit lexojmë se fjalët e para

që profetët ua përcollën njerëzve ishin urdhërimi për devotshmëri. Kur devotshmëria është e pranishme, është i pranishëm edhe udhëzimi i Zotit. Agjërimi është parahyrje në devotshmëri.

❖ Jeta e njeriut ecën gjithmonë në dy rrugë paralele. Njëra nga këto dy rrugë është ajo që i çon kalimtarët drejt përsosurisë. Rruga tjetër është ajo që i çon kalimtarët drejt rënies dhe drejt Xhehenemit. Personi që dëshiron të udhëtojë drejt Zotit, është afër në rrugën e tij. Edhe distanca që duhet të kalojë është e shkurtër.

❖ Kontrollimi i dëshirave tona është më i lehtë në muajin e Ramazanit, sepse në momentin kur vendosim të shkojmë kundër dëshirave tona, ne përshkojmë rrugën e përsosjes dhe të lartësimit shpirtëror.

❖ Me frytin e lutjes rigjallërohet shoqëria. Shfrytëzoje muajin e Ramazanit. Jetoji ditët e tij me agjërim dhe netët e tij me përkujtim dhe lutje. Lidhja me lutjen është lidhja juaj e zemrës me Zotin. Lutje do të thotë kërkesë dhe shpresë. Nëse nuk ke shpresë, nuk i kërkon Zotit asgjë. Një person i dëshpëruar është ai që nuk kërkon asgjë. Prandaj, lutje do të thotë shpresë, shpresë për përgjigje dhe kjo shpresë për

përgjigje është ajo që i pushton zemrat dhe i ndriçon ato. Me bekimin e lutjes, shoqëria bëhet aktive.

❖ Muaji i Ramazanit është një mundësi për rritjen dhe përsosjen e shpirtit njerëzor. Qëllimi kryesor i agjërimit të Ramazanit është që të afrohet tek Zoti dhe të vishet me moralin e Zotit. Muaji i Ramazanit është një mundësi për rritjen dhe lartësimin e shpirtit njerëzor.

❖ Mundet që njeriun e ka rrethuar pakujdesia ndaj Zotit dhe i është bllokuar rruga për te Zoti. Agjërimi në muajin e Ramazanit i jep një mundësi besimtarit të udhëheqë shpirtin drejt ngjitjes dhe përsosurisë dhe të afrohet më shumë te Zoti duke u veshur me moralin e Zotit.

❖ Me namazet i drejtohem Zotit, përmirësojmë veten dhe mbajmë larg ndryshkun, shkujdesjen dhe sëmundjet shpirtërore. Kushti që kjo të ndodhë, është t'i kushtoni vëmendje asaj që bëni dhe asaj që thoni kur jeni në namaz. Lutjet e Ramazanit i japin njeriut ndriçim të dyfishtë.

❖ Gjatë këtyre njëzet e nëntë a tridhjetë ditëve të agjërimit, përveç pesë namazeve të detyrueshme dhe

namazeve vullnetare që njeriu mund të kryejë gjithmonë, ka edhe lutje që e shumëfishojnë ndriçimin e njeriut, duke i lexuar ato. Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) na i ka bërë të disponueshme këto lutje dhe na ka mësuar se si të flasim dhe si të komunikojmë me Zotin.

❖ Muaji i Ramazanit është muaji i ndwrtimit tw vetes dhe i devotshmërisë. A jemi në gjendje që nëpërmjet agjërimit dhe adhurimit në këtë muaj fisnik, t'i shtojmë diçka vetes dhe të forcohemi, apo jo? Bëja këtë pyetje vetes çdo ditë në këtë muaj të shenjtë. Nëse vëreni se keni arritur ndonjë fryt, përpiquni ta ruani atë gjatë gjithë vitit.

❖ Vëllezër dhe motra! Ne duhet të përpiqemi të ringjallim shpirtin e adhurimit në shpirtrat tanë. Adhurim do të thotë nënshtrim ndaj Zotit. Adhurim do të thotë të thyejmë atë idhull që ekziston në shpirtrat tanë e që është uni. Nëse do të mundemi që ta zbusim plotësisht këtë ego, këtë un, këtë pasion psikologjik, këtë faraon të brendshëm, këtë djall brenda nesh, atëherë gjithçka do të jetë mirë dhe do të shndërrohemi në qenie njerëzore të vërteta. Muaji i Ramazanit është një hyrje për këtë qëllim. Agjërimi, namazi me përqëndrim, shpenzimi, madje, edhe xhihadi për hir të Zotit janë përcaktuar që njerëzit të jenë rob të Allahut në këtë jetë.

❖ Prania e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) konsiderohet një mësim i përjetshëm dhe i paharrueshëm për të gjithë brezat njerëzorë, nga shumë aspekte, rrethana dhe situata të ndryshme. Ai është mësim në punët tona individuale dhe personale, në adhurimin tonë, në monologun tonë, në asketizmin tonë, në përmendjen e Zotit, në luftën tonë me vetveten dhe në luftën tonë për të ngritur flamurin e së vërtetës dhe për të vendosur drejtësinë.

❖ Imam Aliu është Prijësi i besimtarëve, imami ynë dhe imami i të gjithë muslimanëve. Por cili është kuptimi i imamit? Kuptimi është ne të vërejmë dimensionet e këtij personaliteti si shembull i lartë për ne dhe të përpiqemi të ndërtojmë diçka të ngjashme me të.

❖ Të njohim virtytet e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ta duam Imam Aliun. Por kjo nuk mjafton. Duhet ta afrojmë veten te qendra e dritës. Karakteristikë e këtij afërimi është ndriçimi. Ne duhet të ndriqohemi me punën, jo me dashurinë e zbrazët; të ndriqohemi me punën që na e dikton dhe na e kërkon kjo dashuri. Me punën tonë të bëhemi pjesë e kësaj familjeje të pastër dhe pjesë e atyre që e ndjekin atë. Nuk është aspak e lehtë që njeriu të bëhet Kamberi në shtëpinë e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Nuk është

e lehtë që njeriu të bëhet Selmani i Ehli Bejtit. Duhet punë, altruizëm, e moral i tyre (Ehli Bejtit).

❖ Nëse keni fituar ndonjë fryt gjatë muajit të Ramazanit, ruajeni atë! Ditën e Bajramit, myslimanët duhet të shikojnë nga afër veten e tyre dhe të ndiejnë përfitimet që kanë arritur nga mikpritja e bekuar e Ramazanit.

❖ Lutja është mjeti i besimtarit, streha e nevojtarit dhe lidhja e të dobëtimit dhe e të paditurit me burimin absolut të diturisë dhe të fuqisë. Personi që e humb lidhjen shpirtërore me Zotin dhe nuk i drejtohet të Vetëmjaftueshmit për të kërkuar atë që i nevojitet, është i hutuar, i pafuqishëm dhe i humbur. Në Kur'an thuhet: **“Thuaj: ‘Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj’...”**

❖ Një nga fazat e agjërimit është largimi nga gjërat e ndaluara, që do të thotë se njeriu duhet t'i mbrojë veshët, sytë, gjuhën, zemrën, madje edhe lëkurën dhe flokët e tij - siç thuhet në disa transmetime nga mëkatet. Transmetohet se imami i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Agjërimi është largimi i besimtarit nga gjërat e ndaluara, ashtu siç është larguar nga ushqimi dhe uji”.*

❖ Të dashurit e mi! Namazi i Bajramit të Ramazanit, në një kuptim, do të thotë falënderim për këtë lindje të re. Në namazin e Bajramit të Ramazanit, e lusim Allahun e Madhëruar, duke thënë: O Zoti ynë! Na fut ne në të gjitha të mirat që ke futur Muhamedin dhe familjen e tij! Na largo nga të gjitha të këqijat, prej të cilave ke larguar Muhamedin dhe familjen e tij. Bekimet e tua qofshin mbi Muhamedin dhe familjen e tij të nderuar! Ditën e Bajramit të Ramazanit, e lusim Allahun e Madhëruar, që të na e pranojë këtë lutje. Natyrisht që ne e kemi për detyrë të bëjmë përpjekje për të qëndruar në Rrugën e Drejtë. Kjo është ajo devotshmëria e bekuar.

❖ Kur'ani dëshiron që myslimanët të jenë syhapët. Përballë vullnetit të Zotit dhe Kur'anit qëndron vullneti i të dehurve nga pushteti dhe i robërve të epshit. Ajeti 26 i sures "En Nisa" shpjegon vullnetin e Zotit: **"Allahu dëshiron që t'ju sqarojë, t'ju udhëzojë në rrugën e të Dërguarve të mëparshëm dhe t'jua pranojë pendimet tuaja. Allahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."** Kjo do të thotë se Allahu dëshiron t'ju udhëzojë dhe t'ju tregojë Rrugën e Drejtë, t'ju ndriçojë dhe t'ju bëjë të vetëdijshëm.

❖ Arrogance te një person është një nga cilësitë e dënueshme etike dhe morale. Edukatorët dhe dijetarët e etikës e kanë klasifikuar atë si një nga tiparet shkatërruese

të fesë. Shkelja e kufijve nuk është gjë tjetër, veçse shfaqje e tiranisë dhe e arrogancës, përfshirë këtu edhe imazhin e shëmtuar dhe të turpshëm që sjellin. Rreziku më i madh për një person vjen atëherë kur ai mbërthehet nga tirania dhe arroganca. Dhe kjo është një fatkeqësi që mund gjithkënd.

❖ Drita e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ndriçonte vetëm kur ai shkonte në xhami dhe kur u fliste njerëzve; ajo ndriçonte edhe kur ai ishte ulur në shtëpinë e tij, kur ishte në heshtje, kur ecte apo kur ishte në fushën e betejës. Në të gjitha këto situata dhe kushte, prania e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndriçonte. Ai ishte dritë dhe ndriçonte si drita. Kjo ndodhte ngaqë lëvizjet e tij, qetësia e tij, fjalët e tij dhe veprimet e tij ishin të gjitha në shërbim të Zotit dhe për hir të Zotit.

❖ Shpresa jonë është te mirësia e Allahut dhe ndihma e Allahut. Ato janë të pashtershme. Zoti i Madhëruar thotë: **“Dhe me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për t'i ndihmuar ata”**. Në një ajet tjetër Allahu thotë: **“Dhe pa dyshim që Allahu do ta ndihmojë atë që e ndihmon Atë”** (El-Haxh, 40). Ky është konfirmim i Allahut. Ndihma e Allahut do të përfshijë - në dashtë Zoti - popullin palestinez dhe bota islame do të shohë zhdukjen e menjëhershme të

gjëdrës kancerogjene sioniste. Ne e presim këtë ditë. Dhe ajo do të vijë, dashtë Zoti dhe patjetër që do të vijë. Kjo e bën më të rëndë përgjegjësinë për të gjithë ne, veçanërisht përgjegjësinë për liderët e vendeve islame. Prandaj të gjithë duhet të përpiqemi për Palestinën dhe për popullin palestinez. Hapi më i rëndësishëm sot është ndalimi i mbështetjes së entitetit uzurpues sionist dhe mbështetjen e popullit të Gazës, e popullit palestinez dhe e rezistencës palestineze me çdo mënyrë të mundshme. Shpresojmë që Zoti i Madhëruar të na udhëzojë të gjithëve në këtë rrugë.

جملات گرانبهای

از آیه الله العظمی السید علی الخامنئی (دام ظلہ الشریف)

تیرانا 2025

اسم الكتاب: جملات گرانبهای

از آية الله العظمى السيد على الخامنئى (دام ظله الشريف)

المترجم: الحاج ولنت مریا

التصحیح الأدبی: پروفیسور دکتر خیری شہو

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فرا

ناشر: جمعية النسيم - تیرانا - ألبانيا